



QKLL 2025

AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT


ALDA BARDHYLI – DREJTORE E QKLL

PËRGATITI: DR. ANILA VOGLI MAKRI

SHTATOR



9 SHTATOR 2025 / PREZANTIMI I LIBRIT TË HENRY KISSINGER “LIDERSHIPI”, PËRKTHYER NË SHQIP



11 shtator 2025 / Përrurimi i romanit “Pallati i dëshpërimit”, të autorit Ena Bulku



1 SHTATOR 2025 / MAKS VELO – NË 90-VJETORIN E TIJ TË LINDJES



Në kuadër të “Vitet Maks Velo” si dhe 90-vjetorit të tij të lindjes, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit organizoi në ambientet e saj një aktivitet me temë “Maks Velo - Polemisti i rezistencës, sensualizmit dhe lirisë estetike”

12 shtator 2025 / Rreth librit “Dinamikat komplekse të hapësirave të lirisë” të profesor Shpëtim Camit



30 SHTATOR 2025 / DITA NDËRKOMBËTARE E PËRKTHIMIT - “PËRKTHIMI, KUFIJTË KOHORË DHE GJUHA”



Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Përkthimit, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, në bashkëpunim me Shoqatën e Përkthyesve Shqiptarë, organizuan aktivitetin:
“Përkthimi, kufijtë kohorë dhe gjuha”

30 SHTATOR 2025 / SHPALLET JURIA E POETIT LAUREAT 3



22 SHTATOR 2025 / SHPALLET JURIA E ÇMIMEVE KOMBËTARE TË LETËRSISË PËR VITIN 2024



12 shtator 2025 / Rreth librit “Përballë një bote e realiteti sfidues” të autorit Aladin Stafa





QKLL 2025

SHTATOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

9 SHTATOR 2025 / PREZANTIMI I LIBRIT TË HENRY KISSINGER “LIDERSHIP”, PËRKTHYER NË SHQIP



Në ambientet e Kryeministrisë u bë prezantimi i librit të Henry Kissinger “Lidershipi”, që vjen në shqip përmes një botimi të veçantë, ku përmes gjashtë rrëfimesh spektakolare mbi gjashtë udhëheqës botërorë, mund të admirohet gjenialiteti i një prej mendjeve më të mprehta të politikës botërore mbi artin e udhëheqjes.

Libri erdhi në shqip nga shtëpia

botuese “MediaUnion”, me një parathënie të shkruar nga kryeministri, z. Edi Rama.

Në aktivitet ishte i pranishëm edhe ish-Kryeministri dhe ish-ministri i Jashtëm i Italisë, Massimo D’Alema, i cili u vlerësua nga Rama si një personalitet i shquar i politikës europiane. Gazetari dhe studiuesi Remzi Lani, i pranishëm në prezantim, reflektoi mbi tezat e Kissinger-it dhe theksoi mungesën e lidershipit të vërtetë në botën e sotme.



QKLL 2025

SHTATOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

1 SHTATOR 2025 / MAKS VELO – NË 90-VJETORIN E TIJ TË LINDJES

Në kuadër të “Vitit Maks Velo” si dhe 90-vjetorit të tij të lindjes, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit organizoi në ambientet e saj një aktivitet me temë “Maks Velo - Polemisti i rezistencës, sensualizmit dhe lirisë estetike” ku morën pjesë artistë të artit pamor dhe

njerëz të kulturës, të cilët biseduan mbi kompleksitetin e Maks Velos, polemikat që ai ndezi në të gjallë të tij, rezistencën ndaj përcudnimit politik, shoqëror dhe human, por edhe mbi universalitetin e artit të tij.



30 SHTATOR 2025 / DITA NDËRKOMBËTARE E PËRKTHIMIT - “PËRKTHIMI, KUFIJTË KOHORË DHE GJUHA”



Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Përkthimit, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, në bashkëpunim me Shoqatën e Përkthyesve Shqiptarë, organizuan aktivitetin: “Përkthimi, kufijtë kohorë dhe gjuha” Takimi u organizua në ambientet e QKLL, ku morën pjesë profesionistë të përkthimit dhe gjuhëtarë.

Dita Ndërkombëtare e Përkthimit kremtohet gjithmonë si një mundësi për të nderuar punën e profesionistëve të gjuhës, veçanërisht atyre të përkthimit, që luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e dialogut dhe komunikimit të vlerave kulturore të ndërsjella, midis kombeve e kulturave.

30 SHTATOR 2025 / SHPALLET JURIA E POETIT LAUREAT 3

Juria e Poetit Laureat 3:

Kryesohet nga poeti Primo Shllaku dhe anëtarë: Aleksandër Çipa, prof. Ymer Çiraku, Majlinda Nana, Koloreto Cukali.





QKLL 2025

SHTATOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

22 SHTATOR 2025 / SHPALLET JURIA E ÇMIMEVE KOMBËTARE TË LETËRSISË PËR VITIN 2024



Shpallet Juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024:

Besnik Mustafaj shkrimtar,
Dhurata Shehri profesore e letërsisë, studiuese,
Elsa Skënderi profesore në UT,
Maklena Nika poete, përkthyesë,
Fatmira Nikolli gazetare e kulturës.

11 SHTATOR 2025 / PËRURIMI I ROMANIT “PALLATI I DËSHPËRIMIT”, TË AUTORES ENA BULKU

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit organizoi përurimin e romanit “Pallati i dëshpërimit”, të autores Ena Bulku, botuar nga Ombra GVG. Morën pjesë botues, shkrimtarë dhe dashamirës të librit.

Romani “Pallati i dëshpërimit” ishte një ndër veprat fituese të Fondit të Krijimtarisë Letrare për të Rinj për vitin 2025.





QKLL 2025

SHTATOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

12 SHTATOR 2025 / RRETH LIBRIT “DINAMIKAT KOMPLEKSE TË HAPËSIRAVE TË LIRISË” TË PROFESOR SHPËTIM CAMIT

Bazuar në rekomandimet e UNESCO-s për Shkencën e Hapur


Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit
Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
Kolegji Universitar i Biznesit

organizojnë:

Bashkëbisedim rreth librit:
“Dinamikat Komplekse të Hapësirave të Lirisë”
të Profesor Shpëtim Camit

DATA: **16 Shtator**
ORA: **11:00**

VENDODHJA: **Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, Tiranë**



Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit në bashkëpunim me Kolegjin Universitar të Biznesit organizoi një bashkëbisedim rreth librit “Dinamikat komplekse të hapësirave të lirisë” të profesor Shpëtim Camit.

Profesor Shpëtim Cami - me një përvojë 35-vjeçare në fushën e arsimit, shkencës, politikës, administratës, shoqërisë civile dhe në fushën e botimeve.

12 SHTATOR 2025 / RRETH LIBRIT “PËRBALLË NJË BOTE E REALITETI SFIDUES” TË AUTORIT ALADIN STAF

“Përballë një bote e realiteti sfidues”, quhet libri i parë i autorit Aladin Stafa, botuar nga shtëpia botuese “mediaprint”, i cili sjell një qasje plot ide e kulturë ndaj zhvillimeve të kohës. Në hapësirat e QKLL ai zhvilloi një dialog me të rinjtë mbi sfidat e kulturës dhe të zhvillimit.





QKLL 2025

SHTATOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

